

VENDIM
Nr.8, datë 2.2.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË SUBVENCIONIMIT TË HEKURUDHAVE

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- z.Genc Ruli	Kryetar
- znj.Mimoza Dhëmbi	Anëtare
- znj.Mimoza Vokshi	Anëtare
- z.Viktor Gumi	Anëtar
- z.Ledi Bianku	anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.2.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, me shkresën nr.4329/4, datë 16.8.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.A1/05/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e subvencionit të hekurudhave është ligji nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, si dhe udhëzimi nr.8, datë 27.1.2006 “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2005”, si dhe të gjitha ligjet e buxhetit në vite.

Objekti/at: Skema synon të ndihmojë Hekurudhën Shqiptare sh.a. duke i ofruar një subvencionim të përvitshëm nga Buxheti i Shtetit, në mënyrë që të kompensohen kostot e ofrimit të shërbimeve publike, në veçanti, mbulimin e shpenzimeve operative të shërbimit të transportit të udhëtarëve. Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema mbulon sektorin e hekurudhave në vend, duke synuar mbulimin e një pjese të kostove të ofrimit të shërbimeve publike për transportin e udhëtarëve.

2. Skema mund të justifikohet për shkak të natyrës së saj, për kontributin që jep në zhvillimin rajonal, pasi kjo masë klasifikohet si një shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik.

3. Në dhënien dhe zbatimin e skemës në vite nuk ka pasur një plan zhvillimi të sektorit, ka munguar analiza e treguesve ekonomiko-financiarë të ndërmarrjes së hekurudhave dhe për shumë vjet ndërmarrja nuk ka pasur në dispozicion fondet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe investimet, të domosdoshme për ta shndërruar atë në një ndërmarrje efikase.

4. Nuk ka masa konkrete për zbatimin e nenit 63 pika 1 të Kodit Hekurudhor, të miratuar me ligjin nr.9317, datë 18.11.2004 në lidhje me përcaktimin e tarifave të ofrimit të shërbimit të transportit të udhëtarëve. Duke qenë se për hekurudhat është ende në fuqi kontrolli i çmimeve, Hekurudha Shqiptare nuk është e lirë të caktojë vetë tarifat për mallrat dhe udhëtarët, gjë që sjell që të ardhurat mesatare për njësi trafiku në Shqipëri të jenë të ulëta.

5. Nuk ka një ndarje të llogarive për shërbimet e ofruara nga Hekurudha Shqiptare sh.a. në mënyrë që të përaktohet saktë kostoja e ofrimit të shërbimit publik (transportit të udhëtarëve) dhe të shmanget çdo mbikompensim, që mund të vijë për shkak të problemeve të ndryshme, përfshirë keqmenaxhimin në vite.

6. Nuk ka masa me afate konkrete për liberalizimin e sektorit, hapjen e tij për konkurrencë dhe as për ndarjen e menaxhimit të infrastrukturës nga shërbimet e tjera që ofron transporti hekurudhor.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13 shkronja “c” dhe nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.2.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

PROPOZON:

1. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, brenda datës 31 mars 2007, të lidhë kontratën publike me Hekurudhën Shqiptare sh.a., në të cilën të përcaktohet qartë detyrimi i Hekurudhës Shqiptare sh.a. për të ofruar shërbimin publik të transportit të udhëtarëve.

2. Të bëhet ndarja e llogarive për pjesën që i takon transportit të udhëtarëve nga veprimtaritë e tjera të Hekurudhës Shqiptare brenda datës 31 korrik 2007, në mënyrë që të përcaktohen saktë kostot e ofrimit të shërbimit publik. Të bëhet llogaritja e saktë e vlerës së kompensimit që Hekurudha Shqiptare mund të përfitojë për të ofruar këtë shërbim publik.

3. Në rast se nuk do të kompensohet e gjithë shuma e nevojshme për ofrimin e shërbimit publik të transportit të udhëtarëve, atëherë të lejohet Hekurudha Shqiptare të përshtatë tarifat për vlerën e pambuluar nga subvencioni.

4. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të marrë të gjitha masat, deri në fund të vitit 2007, për përgatitjen e një plani për zhvillimin e sektorit hekurudhor, në mënyrë që ai të hapet për konkurrencë, duke filluar nga ndarja e menaxhimit të infrastrukturës prej shërbimeve të tjera të transportit hekurudhor.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli